

Banka e Shqipërisë

**INSTRUMENTET E
POLITIKËS MONETARE
TË BANKËS SË
SHQIPËRISË DHE
PROCEDURAT PËR
REALIZIMIN E TYRE**

2008

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

Në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:

Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë, Shqipëri,
Tel.: +355-(0)4-2222152;
Faks: +355-(0)4-2223558

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 2500 kopje

P Ë R M B A J T J A

1.	KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI KUADRIN OPERACIONAL TË BANKËS SË SHOIPËRISË	5
1.1	POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHOIPËRISË	5
1.2	INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE	5
1.3.	PJESËMARRËSIT NË OPERACIONE	9
1.4.	GARANCITË PËR OPERACIONET KREDITUESE	9
1.5	NDRYSHIMI I INSTRUMENTEVE	9
2.	KRITERET OË DUHET TË PËRMBUSHIN PARTNERËT E BANKËS SË SHOIPËRISË PËR PËRDORIMIN E INSTRUMENTEVE TË POLITIKËS MONETARE	10
2.1	TË PËRGJITHSHME	10
2.2	KRITERET PËR TË QENË PARTNER I BANKËS SË SHOIPËRISË NË OPERACIONET E TREGUT TË HAPUR TË REALIZUARA ME MARRËVESHJE RIBLERJEJE (TË ANASJELLTË) RIBLERJEJE	10
2.3	KRITERET PËR TË QENË OBJEKT I REZERVËS SË DETYRUAR	11
3.	OPERACIONET E TREGUT TË HAPUR	12
3.1	TË PËRGJITHSHME	12
3.2	MARRËVESHJET E RIBLERJES DHE TË ANASJELLTA TË RIBLERJES (REPO DHE R/REPO)	12
3.3	TRANSAKSIONET E SHITBLERJEVE ME TË DREJTA TË PLOTA	16
4.	LEHTËSITË E PËRHERSHME	17
4.1	DEPOZITA NJËDITORE	17
4.2	KREDIA NJËDITORE	18
5.	INSTRUMENTE MBËSHTETËSE	20
5.1	KREDIA LOMBARD	20
6.	PROCEDURAT	22
6.1	PROCEDURAT E ANKANDEVE TË OPERACIONEVE TË TREGUT TË HAPUR NËPËRMJET MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLTA TË RIBLERJES	22
6.2	REALIZIMI I MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLTA TË RIBLERJES NËPËRMJET PROCEDURAVE DYPALËSHE	27
6.3	PROCEDURAT PËR TRANSAKSIONET E SHITBLERJEVE ME TË DREJTA TË PLOTA	27
6.4	PASTRIMI I LLOGARIVE	28
7.	GARANCITË E OPERACIONEVE KREDITUESE DHE VLERËSIMI I TYRE	30
7.1	AKTIVET OË MUND TË PËRDOREN SI GARANCI	30
7.2	VLERËSIMI I GARANCIVE	30
7.3	MASAT PËR KUNDËRVAJTJEN E BANKAVE NË LIDHJE ME PLOTËSIMIN E KËRKESAVE PËR VENDOSJEN DHE RUAJTJEN E NIVELIT TË GARANCISË	31
8.	REZERVA E DETYRUAR	34
8.1	TË PËRGJITHSHME	34
8.2	PËRCAKTIMI I MINIMUMIT TË REZERVËS SË DETYRUAR	34
ANEKSI 1	SHEMBUJ TË REALIZIMIT TË DISA PREJ OPERACIONEVE MONETARE TË BANKËS SË SHOIPËRISË	41
ANEKSI 2	FJALOR	50



1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI KUADRIN OPERACIONAL TË BANKËS SË SHOIPËRISË

1.1 POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHOIPËRISË

Objekti i politikës monetare, që realizohet nga Banka e Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Në terma sasiorë, Banka e Shqipërisë e ka përkthyer objektivin e stabilitetit të çmimeve në mbajtjen e inflacionit në nivelin 3 për qind, me një mundësi luhatjeje prej ± 1 pikë përqindjeje rreth kësaj vlere qendrore.

Për të realizuar objektivin e inflacionit, Banka e Shqipërisë synon të kontrollojë rritjen e mjeteve monetare në ekonomi, në mënyrë që oferta për to të korrespondojë me nevojën e ekonomisë për mjete monetare reale. Rritja e mjeteve monetare kontrollohet nëpërmjet ndjekjes së objektivave operacionalë, në shërbim të të cilëve është edhe kuadri operacional i Bankës së Shqipërisë.

1.2 INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

Banka e Shqipërisë ka në dispozicion një set instrumentesh që e lejojnë atë të ndikojë normat e interesit të tregut dhe të menaxhojë sasinë e likuiditetit në shërbim të realizimit të objektivave operacionalë. Banka e Shqipërisë inicion operacionet e tregut të hapur, ofron lehtësi të përhershme si dhe instrumente mbështetëse për bankat si dhe iu kërkon këtyre të fundit, të mbajnë një rezervë minimale në llogaritë e tyre në Bankën e Shqipërisë.

1.2.1 OPERACIONET E TREGUT TË HAPUR

Operacionet e tregut të hapur janë blerja dhe shitja në treg e letrave me vlerë nga Banka e Shqipërisë, me qëllim shtimin ose kontraktimin e ofertës së parasë në sistemin bankar. Operacionet e tregut të hapur që përdoren nga

Banka e Shqipërisë janë: *marrëveshjet e riblerjeve (të njohura si REPO) dhe ato të anasjellta të riblerjeve (R/REPO)*, si dhe *shitblerjet e bonove të thesarit me të drejta të plota*. Në përputhje me qëllimin, me frekuencën dhe me procedurat, marrëveshjet e riblerjes dhe ato të anasjelltat konsiderohen si transaksione me efekte të përkohshme ndërkohë që shitblerjet me të drejta të plota konsiderohen si transaksione me efekt të përhershëm.

Marrëveshjet e riblerjes (REPO) dhe ato të anasjellta janë forma më e shpeshtë e operacioneve të tregut të hapur të përdorura nga bankat qendrore. Marrëveshjet e riblerjes nënkuptojnë shitjen e letrave me vlerë nga Banka e Shqipërisë bankave, të shoqëruar me detyrimin e të parës për t'i riblerë letrat me vlerë në një datë të caktuar dhe me një çmim të caktuar. Shitja e letrave me vlerë nga ana e bankës qendrore është ekuivalente me vendosjen e një depozite nga bankat në bankën qendrore. Nga ana tjetër, marrëveshjet e anasjellta të riblerjes nënkuptojnë blerjen nga ana e Bankës së Shqipërisë të letrave me vlerë bankave, të shoqëruar me detyrimin e këtyre të fundit për t'i riblerë letrat me vlerë me një çmim të caktuar në një datë të caktuar. Blerja e letrave me vlerë nga ana e bankës qendrore është e njëvlerëshme me dhënien e kredi të kolateralizuar nga ana e saj, bankave.

Transaksionet e shitblerjes me të drejta të plota janë operacione nëpërmjet të cilave Banka e Shqipërisë blen ose shet letra me vlerë nga bankat, me qëllim ndryshimin e strukturës së likuiditetit. Blerja e letrave me vlerë nga ana e Bankës së Shqipërisë injekton likuiditet në sistem, ndërkohë që shitja thith likuiditetin.

Operacionet e tregut të hapur ekzekutohen mbi bazën e tre procedurave: ankande standarde, ankande të shpejta dhe marrëdhënie dypalëshe. Marrëveshjet e riblerjes dhe ato të anasjellta me maturim njëjavor, realizohen vetëm nëpërmjet procedurave të ankandëve standarde. Ato luajnë rol kryesor në realizimin e qëllimeve në tregun e hapur të parasë si në rastin e tërheqjes së likuiditeteve ashtu dhe në injektimin e likuiditeteve në treg. Ndërsa marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes me maturim një ditë, një muaj dhe tre muaj si dhe transaksionet me të drejta të plota realizohen nëpërmjet ankandëve të shpejta ose procedurave dypalëshe.

Norma fikse e interesit për marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve, vendoset nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe është objekt i rishikimeve të herëpashershme. Norma e tyre shërben edhe si referencë për të gjitha normat e tjera të instrumenteve në tregun e parasë.

Marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve me afat një ditë, një muaj dhe tre muaj realizohen nëpërmjet ankandëve të shpejta. Këto operacione përfshihen në operacionet rregulluese të Bankës së Shqipërisë dhe

ndihmojnë në administrimin e situatës së likuiditeteve në treg dhe në normat e interesit.

Banka e Shqipërisë kryen edhe operacione strukturore, të cilat realizohen nëpërmjet transaksioneve për shitblerjen me të drejta të plota të letrave me vlerë. Këto transaksione iniciohen nga Banka e Shqipërisë dhe ekzekutohen nëpërmjet ankandeve të shpejta dhe marrëveshjeve dypalëshe. Efekti i këtyre lloj transaksioneve në likuiditete është i përherëshëm.

1.2.2 LEHTËSITË E PËRHERSHME

Lehtësitë e përherëshme janë instrumente që shërbejnë për dhënien dhe për thithjen e likuiditeteve në mënyrë të përkohshme me afat kohor njëditor dhe krijimin e korridorit ku mund të luhaten interesat e tregut ndërbankar. Përdorimi i këtyre lehtësive iniciohet nga bankat. Si lehtësi të përherëshme, Banka e Shqipërisë ofron instrumentin e depozitës njëditore dhe atë të kredisë njëditore.

- Bankat përdorin instrumentin e depozitës njëditore për të investuar likuiditetin e tyre të tepërt në Bankën e Shqipërisë me afat kohor njëditor. Në kushte normale, nuk ka kufij në shumën e depozitës njëditore apo kufizime për bankat që të përdorin këtë lehtësi. Norma e interesit të depozitës njëditore aktualisht është 1.75 për qind nën normën fikse të marrëveshjeve të riblerjes dhe shërben si dysheme për normat njëditore të interesit në tregun ndërbankar të parasë.
- Bankat përdorin instrumentin e kredisë njëditore për të marrë likuiditet nga Banka e Shqipërisë, kundrejt kolateralit me afat kohor njëditor. Në kushte normale, nuk ka kufij në shumën e kredisë njëditore apo kufizime për bankat që të përdorin këtë lehtësi, me përjashtim të kërkesës për vendosjen e kolateraleve të mjaftueshme. Norma e interesit të kredisë njëditore aktualisht është 0.75 për qind mbi normën e marrëveshjeve të riblerjes dhe shërben si tavan për normat njëditore të interesit në tregun ndërbankar të parasë.

1.2.3 INSTRUMENTET MBËSHTETËSE

Për bankat që janë me mungesë likuiditeti por financiarisht të qëndrueshme, Banka e Shqipërisë mund të akordojë kredi lombard. Kredia lombard mund të akordohet deri në tre muaj, kundrejt kolateralit. Norma e interesit të kredisë lombard ka referencë normën e marrëveshjeve të riblerjes dhe shërben si norma më e lartë e interesit në tregun e parasë. Aktualisht, është 6 pikë përqindjeje mbi nivelin e normës bazë.

1.2.4 MINIMUMI I REZERVËS SË DETYRUAR

Rezerva minimale e detyruar përfaqëson atë pjesë të fondeve që bankat duhet të mbajnë në llogarinë e tyre pranë Bankës së Shqipërisë, në lekë dhe në valutë.

Mbajtja e rezervës minimale të detyruar në Bankën e Shqipërisë nga bankat, shërben për rregullimin e likuiditetit në sistemin bankar, në drejtim të krijimit të kërkesës për likuiditet dhe për stabilizimin e normave të interesit në treg. Banka e Shqipërisë përcakton zërat e bilancit kontabël që përfshihen në rezervën e detyruar, ndërkohë që niveli i rezervës së detyruar për çdo bankë përcaktohet nga niveli i zërave të bilancit kontabël të vetë bankës, të përfshirë në rezervën e detyruar dhe nga norma e rezervës së detyruar, e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Me qëllim zvogëlimin e luhatjes së normave të interesit në tregun ndërbankar të parasë që mund të shkaktohet nga nevoja e paparashikuar për likuiditet, bankave iu lejohet përdorimi i rezervës së detyruar por duke ruajtur nivelin e saj mesatarisht gjatë periudhës së mbajtjes. Interesi që bankat marrin për rezervën minimale të detyruar, që mbahet nga Banka e Shqipërisë, llogaritet si përqindje e normës së marrëveshjeve të riblerjes, të shpallur nga Banka e Shqipërisë për rezervat në lekë dhe si përqindje e normës bazë të Bankës Qendrore Evropiane dhe Bankës Federale të SHBA-së respektivisht, për rezervën e detyruar në euro dhe në dollarë.

Tabelë 1. Kuadri i operacioneve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

Operacionet e politikës monetare	Tipi i transaksioneve		Maturiteti	Frekuenca	Procedura
	Shtim likuiditeti	Tërheqje likuiditeti			
Operacionet e tregut të hapur					
Marrëveshje e riblerjes dhe e anasjelltë e riblerjes njëjavore	Marrëveshje e anasjelltë e riblerjes	Marrëveshje e riblerjes	Shtatë ditë	Javore	Ankand standard
Marrëveshje e riblerjes dhe e anasjelltë e riblerjes njëditore	Marrëveshje e anasjelltë e riblerjes	Marrëveshje e riblerjes	Një ditë	E pastandardizuar	Ankande të shpejta
Marrëveshje të riblerjes dhe e anasjelltë e riblerjes njëmuajore	Marrëveshje e anasjelltë e riblerjes	Marrëveshje e riblerjes	Një muaj	E pastandardizuar	Ankande të shpejta Procedura dypalëshe
Marrëveshje e riblerjes dhe e anasjelltë e riblerjes tremujore	Marrëveshje e anasjelltë e riblerjes	Marrëveshje e riblerjes	Tre muaj	E pastandardizuar	Ankande të shpejta Procedura dypalëshe
Blerje dhe shitje me të drejta të plota, të letrave me vlerë	Blerje me të drejta të plota	Shitje me të drejta të plota		E pastandardizuar	Procedura dypalëshe Ankande të shpejta
Lehtësitë e përhershme					
Kredi njëditore	Hua e kolateralizuar		Një ditë	Në kushte normale sipas nevojës së bankave	
Depozitë njëditore		Depozitë	Një ditë	Në kushte normale sipas nevojës së bankave	
Instrumentet mbështetëse					
Kredia lombard	Hua e kolateralizuar		Deri në tre muaj	E pastandardizuar	Procedura dypalëshe

1.3. PJESEMARRËSIT NË OPERACIONE

Në bazë të kuadrit rregullativ të funksionimit të instrumenteve të politikës monetare, palë në operacionet e tregut të hapur, në përdorimin e lehtësive të përhershme dhe instrumenteve mbështetëse si dhe në mbajtjen e minimumit të rezervës së detyruar, janë vetëm bankat e lincencuara nga banka qendrore dhe që kanë llogari rezervë në Bankën e Shqipërisë.

Krahas kësaj, për t'u konsideruar partner në lidhjen e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, bankat duhet të kenë nënshkruar kontratë me Bankën e Shqipërisë, sipas të cilës palët bien dakord për të drejtat dhe detyrimet gjatë lidhjes së marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes.

1.4. GARANCITË PËR OPERACIONET KREDITUESE

Operacionet e kreditimit të Bankës së Shqipërisë (operacionet që injektojnë likuiditete) kanë nevojë të sigurohen me kolaterale. Si vlera të pranuar nga Banka e Shqipërisë për garantimin e kredive, janë letrat me vlerë të qeverisë të tregtueshme në tregun sekondar. Këto kolaterale sigurohen që janë në portofolin e bankave si dhe vlerësohen sipas kushteve të përcaktuara paraprakisht.

1.5 NDRYSHIMI I INSTRUMENTEVE

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në çdo kohë, në përputhje me zhvillimet më të fundit në tregun e parasë, vendos për instrumentet, kushtet, kriteret dhe procedurat për ekzekutimin e operacioneve të politikës monetare.

2. KRITERET QË DUHET TË PËRMBUSHIN PARTNERËT E BANKËS SË SHQIPËRISË PËR PËRDORIMIN E INSTRUMENTEVE TË POLITIKËS MONETARE

2.1 TË PËRGJITHSHME

Kriteret për të qenë partner i bankës qendrore në realizimin e operacioneve dhe përdorimin e instrumenteve të saj janë vendosur në mënyrë të tillë, që të sigurojnë pjesëmarrjen e gjerë të aktorëve kryesorë të tregut (bankat), trajtim të barabartë për ta si dhe përbushjen e disa detyrimeve për të qenë partner operacional i bankës qendrore. Si kriteret të përgjithshme konsiderohen:

- Duhet të jenë të licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe të ushtrjnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Të kenë llogari në sistemin e pagesave të Bankës së Shqipërisë.

Këto kriteret janë të përbashkëta dhe përbëjnë bazën për të qenë partner në operacionet e tregut të hapur, për të përdorur lehtësitë e përhershme dhe instrumentet mbështetëse si dhe për t'u konsideruar subjekt i rezervës së detyruar.

2.2 KRITERET PËR TË QENË PARTNER I BANKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONET E TREGUT TË HAPUR TË REALIZUARA ME MARRËVESHJE RIBLERJEJE (TË ANASJELLTË) RIBLERJEJE

Krahas kriterëve të përgjithshme të përmendura më lart, për të hyrë në marrëveshje riblerjeje ose të anasjelltë riblerjeje me Bankën e Shqipërisë, bankat duhet të kenë nënshkruar "Kontratën mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes". Kjo kontratë përmbledh të gjitha detyrimet dhe të drejtat e palëve për lidhjen dhe ekzekutimin e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes.

2.3 KRITERET PËR TË QENË OBJEKT I REZERVËS SË DETYRUAR

Bankat që plotësojnë kriteret bazë (të jenë të licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe të kenë llogari në sistemin e pagesave të saj), por që janë vendosur në likuidim, përjashtohen nga detyrimi për mbajtjen e rezervës së detyruar. Nga detyrimi i mbajtjes së rezervës së detyruar përjashtohen edhe bankat të cilave iu revokohet licenca.

3. OPERACIONET E TREGUT TË HAPUR

3.1 TË PËRGJITHSHME

Operacionet e tregut të hapur përfaqësojnë blerjen apo shitjen në treg të letrave me vlerë nga ana e Bankës së Shqipërisë. Ato luajnë rolin kryesor në transmetimin e politikës monetare në sistemin bankar. Qëllimi i përdorimit të operacioneve të tregut të hapur është administrimi afatshkurtër i likuiditetit të sistemit bankar, me synim stabilizimin e normave të interesit të tregut.

Ato janë ekskluzivitet i Bankës së Shqipërisë, e cila nëpërmjet strukturave të saj, konkretisht Komitetit të Zbatimit të Politikës Monetare vendos llojin e instrumentit që do të përdorë si dhe kushtet përkatëse lidhur me ekzekutimin e tyre.

Sipas qëllimit të përdorimit të tyre, operacionet e tregut të hapur ndahen në: *operacioni kryesor i tregut, operacione rregulluese dhe operacione strukturore*. Marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes përdoren si operacioni kryesor i tregut dhe si operacione rregulluese, ndarje e cila ka për bazë kohëzgjatjen e instrumentit. Ndërsa shitblerjet me të drejta të plota përdoren vetëm në operacionet strukturore.

3.2 MARRËVESHJET E RIBLERJES DHE TË ANASJELLTA TË RIBLERJES (REPO DHE R/REPO)

3.2.1 TË PËRGJITHSHME

a. Lloji i instrumentit

Marrëveshjet e riblerjes janë operacione të tregut të hapur me anë të të cilave Banka e Shqipërisë shet letra me vlerë, duke marrë përsipër t'i blejë ato sipas kushteve të rëna dakord paraprakisht me një bankë, me qëllim zvogëlimin e përkohshëm të likuiditetit në sistemin bankar.

Ndërsa marrëveshjet e anasjellta të riblerjes janë operacione të tregut të hapur me anën e të cilave, Banka e Shqipërisë blen letra me vlerë duke marrë përsipër t'i shesë ato sipas kushteve të rëna dakord paraprakisht me një bankë, me qëllim rritjen e përkohshme të likuiditetit në sistemin bankar.

b. Natyra ligjore e instrumentit

Letrat me vlerë që tregtohen nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të riblerjes dhe atyre të anasjellta, janë të blera paraprakisht nga Banka e Shqipërisë ose nga bankat në tregun primar apo në tregun sekondar, dhe janë të llojit bono thesari dhe obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë me maturim të mbetur jo më shumë se 365 ditë.

Në marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, e drejta e pronësisë së letrës me vlerë i transferohet kreditorit (blerësit), pas rënies dakord për kryerjen e veprimit të kundërt nëpërmjet ritransferimit të letrës me vlerë debitorit (shitësit), në një datë të caktuar në të ardhmen.

Shuma e kërkesës për pjesëmarrje në ankand është jo më e vogël se 10(dhjetë) milionë lekë dhe mund të shtohet me shumëfisha prej 10 (dhjetë) milionë lekësh.

c. Interesi

Diferenca midis çmimit të blerjes dhe të riblerjes të një letre me vlerë në një marrëveshje riblerjeje, korrespondon me interesin për t'u paguar për likuiditetin e marrë hua (ose për t'u përfituar për likuiditetin e dhënë hua) për të gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes. Me fjalë të tjera, çmimi i riblerjes të letrës me vlerë përfshin edhe interesin e detyruar.

3.2.2 OPERACIONI KRYESOR I TREGUT

Operacioni kryesor i tregut realizohet nëpërmjet marrëveshjes (të anasjelltë) së riblerjes me maturim shtatë ditë, që është instrumenti kryesor i Bankës së Shqipërisë për zbatimin e politikës monetare. Qëllimi i përdorimit të saj është administrimi afatshkurtër i likuiditetit të sistemit bankar, me synim stabilizimin e normave të interesit të tregut. Përcaktimi i normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes me maturim njëjavor, përcakton qëndrimin e politikës monetare.

Karakteristikat themelore të marrëveshjes (të anasjelltë) së riblerjes mund të përmbledhen si më poshtë:

- Realizohet nëpërmjet ankandit me shumë të përcaktuar dhe me shumë çmime ose ankand me çmim fiks dhe me shumë të papërcaktuar.
- Ankandi për këto lloj marrëveshesh organizohet çdo javë dhe është i tipit standard.
- Norma fikse e interesit të marrëveshjes (të anasjelltë) së riblerjes miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Kjo normë shërben si nivel maksimal për marrëveshjet e riblerjes ose minimal për marrëveshjet e anasjellta të riblerjes, për ankandet me shumë çmime.
- Maturimi i këtij instrumenti është shtatë ditë.

Tabelë 2. Llogaritja e çmimit të blerjes dhe të riblerjes në ekzekutimin e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes.

Çmimi i blerjes së letrës me vlerë në marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

a) për bonot e thesarit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë:

$$\text{Çb} = \frac{V_n}{1 + \frac{y}{365} \times D} \quad \text{ku,}$$

Çb - çmimi i blerjes
 V_n - vlera nominale
 y - interesi i tregut
 D - ditët deri në maturim

b) për obligacionet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë:

$$\text{Çb} = \left[\frac{V_n}{\left[1 + \frac{Y}{F}\right]^{\left[N - 1 + \frac{D}{E}\right]}} \right] + \left[\sum_{k=1}^N \frac{V_n \times \frac{C}{F}}{\left[1 + \frac{Y}{F}\right]^{\left[k - 1 + \frac{D}{E}\right]}} \right] + \left[V_n \times \frac{C}{F} \times \frac{A}{E} \right]$$

çb - çmimi i blerjes
 V_n - vlera nominale
 C - kuponi
 Y - interesi i tregut
 F - frekuenca e pagesës së kuponit
 D - numri i ditëve nga data e marrëveshjes deri tek data e kuponit më të afërt

- E - numri i ditëve në periudhën e kuponit
- A - numri i ditëve nga fillimi i periudhës së kuponit deri në datën e marrëveshjes
- N - numri i kuponëve nga dita e marrëveshjes deri në datën e maturimit të obligacionit

Çmimi i riblerjes së letrës me vlerë në marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$C_r = C_b * (1 + \frac{I_r}{365} * d) \quad ku,$$

C_r - çmimi i riblerjes

C_b - çmimi i blerjes

I_r - interesi i riblerjes

d - ditët e kohëzgjatjes së marrëveshjes së riblerjes/të anasjelltë të riblerjes

3.2.3 OPERACIONET RREGULLUESE

Për ekzekutimin e operacioneve rregulluese të tregut të hapur përdoren marrëveshjet (e anasjellta) e riblerjes me maturim një ditë, një muaj dhe tre muaj. Qëllimi i përdorimit të tyre është rregullimi i luhatjeve të papritura në treg. Tiparet operationale të marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes me maturim një ditë, një muaj dhe tre muaj janë:

- Realizohen nëpërmjet ankandit të shpejtë dhe/ose procedurave dypalëshe me frekuencë të papërcaktuar.
- Ankandet janë të llojit me shumë të përcaktuar, ndërkohë që interesi përcaktohet nga pjesëmarrësit.
- Banka e Shqipërisë ka të drejtë të refuzojë kërkesat, interesi i të cilave është i devijuar nga interesi i tregut në ditën që kryhet ankand.
- Maturimi i marrëveshjes (të anasjelltë) të riblerjes njëditore është 1 (një) ditë; i marrëveshjes (të anasjelltë) të riblerjes njëmuajore është 28 (njëzet e tetë) ditë dhe i marrëveshjes (të anasjelltë) të riblerjes tremujore është 91 (nëntë dhjetë e një) ditë.

3.2.4 OPERACIONE STRUKTURORE

Instrumenti që përdoret për kryerjen e operacioneve strukturore të tregut të hapur janë shitblerjet me të drejta të plota. Qëllimi i përdorimit të këtyre operacioneve është ndryshimi i strukturës së likuiditetit të sistemit bankar.

3.3 TRANSAKSIONET E SHITBLERJEVE ME TË DREJTA TË PLOTA

a. Lloji i instrumentit

Transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota janë shitjet ose blerjet me të drejta të plota të letrave me vlerë. Këto operacione kanë efekt të përhershëm në likuiditetin e sistemit bankar.

b. Natyra ligjore e instrumentit

Transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota përfaqësojnë transferimin e plotë të së drejtës të pronësisë nga shitësi tek blerësi, duke mos përfshirë transaksionin e anasjelltë.

c. Karakteristikat operacionale të instrumentit

Në mënyrë të përmbledhur tiparet operacionale të transaksioneve me të drejta të plota janë:

- Marrin formën e shtimit të likuiditetit, në rastin e blerjeve me të drejta të plota ose të pakësimit të likuiditetit, në rastin e shitjeve me të drejta të plota.
- Zhvillohen me frekuencë të papërcaktuar.
- Ekzekutimi i tyre, nëpërmjet ankandeve të shpejta dhe procedurave dypalëshe, miratohet paraprakisht nga Komiteti i Zbatimit të Politikës Monetare.
- Objekt i transaksioneve të shitblerjeve me të drejta të plota janë bonot e thesarit me afat maturimi deri një vit dhe me periudhë të mbetur në maturim jo më pak se shtatë ditë. Gjithashtu, objekt i transaksioneve mund të jenë edhe letra të tjera me vlerë, të cilat duhet të jenë instrumente borxhi, të kenë kredibilitet të lartë, të jenë të formës *book-entry*, e që bëhen objekt i këtyre transaksioneve me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Gjithsesi, aktualisht asnjë letër tjetër me vlerë nuk është miratuar si objekt i këtyre transaksioneve përveç bonove të thesarit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

4. LEHTËSITË E PËRHERSHME

Lehtësitë e përherëshme janë instrumente pa kufizime, në dispozicion të bankave për investimin e likuiditetit të tepërt ose huamarrjen e likuiditetit me afat kohor njëditor. Normat e interesit të këtyre instrumenteve përcaktojnë korridorin ku mund të luhaten interesat e tregut ndërbankar. Karakteristikë është se përdorimi i tyre realizohet gjithmonë dhe ekskluzivisht me nismën e bankave.

4.1 DEPOZITA NJËDITORE

a. Lloji i instrumentit

Depozita njëditore është një instrument afatshkurtër investimi në dispozicion të bankave, nëpërmjet të cilit ato mund të investojnë likuiditetin e tyre të lirë në afatin kohor njëditor dhe me interes të parapërcaktuar. Në kushte normale, norma e interesit të depozitës njëditore shërben si dysHEME për nivelin e interesit në tregun ndërbankar.

b. Natyra ligjore e instrumentit

Bankat kanë të drejtë të vendosin depozitë njëditore pranë Bankës së Shqipërisë në shumë të pakufizuar. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të refuzojë kërkesën e çdo banke për vendosje depozite, në përputhje me synimet e saj, pa mbartur detyrimin e dhënies së shpjegimeve. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë nuk vendos kolateral për depozitat e pranuar.

c. Kushtet e përdorimit të instrumentit

Depozitë njëditore në Bankën e Shqipërisë mund të vendosin të gjitha bankat dhe degët e bankave që përmbushin kriteret e të qenurit partner i Bankës së Shqipërisë.

Për përdorimin e instrumentit të depozitës njëditore, banka duhet të paraqesë kërkesën e saj me shumën përkatëse 15 minuta përpara mbylljes të sistemit të pagesave AIPS, mbyllje e cila aktualisht bëhet në orën 16.00.

d. Maturimi dhe interesi i instrumentit

Maturimi i këtij instrumenti është një ditë. Interesi bashkë me shumën i ripaguhet bankës ditën vijuese të punës. Dita e maturimit mund të shtyhet vetëm në rastin kur dita vijuese është ditë pushimi.

Interesi i depozitës njëditore është i paralajmëruar dhe llogaritet me bazë 365 ditë. Norma e interesit që u paguhet bankave për depozitën njëditore aktualisht është 1.75 pikë përqindje, me bazë vjetore, më e ulët se interesi i marrëveshjeve të riblerjeve me maturim shtatë ditë, i përcaktuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Bankat njoftohen paraprakisht për çdo ndryshim në normën e interesit.

4.2 KREDIA NJËDITORE

a. Lloji i instrumentit

Kredia njëditore është një instrument afatshkurtër borxhi që u vihet në dispozicion bankave. Ajo është kredi plotësisht e garantuar (nga garancitë të përshkruara në paragrafin 7.1), që akordohet për të asistuar bankat me nevoja ditore likuiditeti. Në kushte normale norma e interesit të kredisë njëditore shërben si tavan për nivelin e interesit në tregun ndërbankar.

b. Natyra ligjore e instrumentit

Banka e Shqipërisë akordon kredi njëditore vetëm në formën e kredisë së kolateralizuar, që do të thotë banka që kërkon kredi njëditore duhet të vendosë si kolateral një(disa) letër(a) me vlerë, e cila(të cilat) vlerësohet(en) sipas kushteve të përshkruara në 7.2. Duke marrë në konsideratë plotësimin e detyrimit për kthimin e borxhit, e drejta e pronësisë së letrës me vlerë i mbetet debitorit (bankës që kërkon likuiditet) gjatë kohëzgjatjes së kredisë. Në rast të mosshlyerjes së detyrimit, kolaterali kalon në pronësi të Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë mund të refuzojë kërkesën e çdo banke për kredi njëditore, në përputhje me synimet e saj pa dhënë shpjegime.

c. Kushtet e përdorimit të instrumentit

Instrumenti i kredisë njëditore mund të përdoret vetëm nga partnerët që

përbushin kushtet e partnerit në operacionet e Bankës së Shqipërisë. Bankat, që në përfundim të veprimeve rezultojnë me mungesë likuiditeti, bëjnë kërkesë për kredi njëditore. Nga ana tjetër, në mbyllje të ditës së punës, në rast se konstatohet që banka nuk ka kthyer kredinë brenda ditës në të cilën e ka marrë nga Banka e Shqipërisë, atëherë kredia brenda ditës shndërrohet në kredi njëditore, me të njëjtin kolateral. Banka e Shqipërisë njofton bankën përkatëse për kredinë automatike të akorduar si dhe për bllokimin e kolateralit.

Përtej nevojës për të pasur kolateral të mjaftueshëm për garantimin e kredisë njëditore nuk ka kufizim mbi shumën që një bankë mund të marrë kredi njëditore.

d. Maturimi dhe interesi i instrumentit

Maturimi i instrumentit të kredisë është një ditë. Interesi bashkë me shumën i paguhet Bankës së Shqipërisë ditën vijuese të punës dhe shtyhet për ditën e parë të punës, në rast se dita vijuese është pushim.

Interesi i kredisë njëditore është i paralajmëruar dhe llogaritet me bazë 365 ditë. Kjo normë është 0.75 pikë përqindjeje më e lartë se norma e marrëveshjeve (të anasjelltë) të riblerjes me maturim shtatë ditë. Bankat njoftohen paraprakisht për çdo ndryshim në normën e interesit.

5. INSTRUMENTE MBËSHTETËSE

5.1 KREDIA LOMBARD

a. Lloji i instrumentit

Kredia lombard është instrument borxhi, që ka për qëllim të ndihmojë bankat në kapërcimin e problemeve të përkohshme të likuiditetit, por që kanë qëndrueshmëri financiare. Ajo përfaqëson mundësinë e fundit kredituese për bankat dhe për rrjedhojë, është kredia me normë interesi më të lartë.

b. Natyra ligjore e instrumentit

Kredia lombard është e formës së kredisë së kolateralizuar dhe akordohet pas miratimit të kërkesës zyrtare, bërë nga banka. Kredia lombard miratohet nga Komitetit i Zbatimit të Politikës Monetare.

c. Kushtet e përdorimit të instrumentit

Banka që paraqet kërkesë për kredi lombard, duhet të shoqërojë këtë kërkesë me një raport ku detajohen shkaqet për mungesën e likuiditetit, veprimet e ndërmarra për shfrytëzimin e burimeve të mundshme të likuiditetit, një listë të garancive që do të paraqesë në Bankën e Shqipërisë për sigurimin e kredisë; një plan veprimi për daljen nga situata e mungesës së likuiditetit si dhe një projektplan të lëvizjes së fondeve gjatë kohës së shfrytëzimit të kredisë lombard.

Kredia lombard mund të përdoret vetëm një herë në çdo tre muaj. Shuma më e madhe, që një bankë mund të përfitojë me anë të kredisë lombard, qëndron midis 20 për qind të kapitalit të paguar dhe 2 për qind të depozitave në lekë, sipas gjendjes më të fundit të bilancit të paraqitur prej saj në Bankën e Shqipërisë. Kredia akordohet në ditën që miratohet nga Banka e Shqipërisë. Në rast moskthimi të kredisë në përfundim të afatit të caktuar, bankës nuk i lejohet të marrë asnjë lloj tjetër kredie në tremujorin pasardhës.

d. Maturimi dhe interesi i instrumentit

Afati maksimal i maturimit të kredisë lombard është deri në tre muaj. Në kushte normale, kredia bashkë me interesin i kthehet Bankës së Shqipërisë në përfundim të afatit të caktuar në miratimin e kredisë lombard.

Interesi i kredisë lombard është 6 pikë përqindjeje (me bazë vjetore) mbi interesin e marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes me maturim shtatë ditë. Bankat njoftohen paraprakisht për çdo ndryshim në normën e interesit.

6. PROCEDURAT

6.1 PROCEDURAT E ANKANDEVE TË OPERACIONEVE TË TREGUT TË HAPUR NËPËRMJET MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLTA TË RIBLERJES

6.1.1 LLOJET E ANKANDEVE

Operacionet e tregut të hapur në Bankën e Shqipërisë normalisht zhvillohen nëpërmjet procedurave të ankandit. Banka e Shqipërisë operon me dy lloje ankandesh: ankand i tipit standard dhe ankand i shpejtë. Procedurat e të dy llojeve të ankandëve janë njësoj, përveç kohës së organizimit.

Tabela 3 paraqet hapat e ndjekur gjatë organizimit dhe zhvillimit të ankandëve.

Tabelë 3. Hapat operacionalë për zhvillimin e ankandëve.

- | | |
|---------|---|
| Hapi 1. | Njoftimi për ankandin.
Banka e Shqipërisë njofton të gjitha bankat për llojin dhe për kushtet e ankandit me një prej sistemeve të informacionit si: SWIFT, REUTERS, faks ose shkresë zyrtare. |
| Hapi 2. | Dorëzimi i kërkesave për ankand.
Bankat dërgojnë kërkesat e tyre për pjesëmarrje në ankand me SWIFT, REUTERS, faks ose me shkresë zyrtare në Departamentin e Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë. |
| Hapi 3. | Shqyrtimi i kërkesave.
Kërkesat e bankave për pjesëmarrje në ankand shqyrtohen nga një komision me anëtarë të përhershëm të zëvendësueshëm në rast mungese, punonjës të Departamentit të Operacioneve Monetare dhe të Departamentit të Politikës Monetare. |

Hapi 4. Pranimi dhe shpërndarja e kërkesave.
Komisioni vendos për pranimin dhe shpërndarjen e kërkesave.


Hapi 5. Njoftimi për rezultatin.
a) Rezultati agregat i ankandit publikohet për të gjitha bankat.
b) Bankat pjesëmarrëse marrin njoftimet përkatëse për rezultatet e ankandit.

Hapi 6. Kalimi i veprimeve pas përfundimit të ankandit.

a. Ankandi standard

Ankandet standarde ekzekutohen 24 orë pas njoftimit të bërë nga Banka e Shqipërisë. Këto ankande zhvillohen çdo të javë, ditën e mërkurë ose ditën paraardhëse kur e mërkura është pushim zyrtar. Diagrama 1 paraqet etapat kohore të zhvillimit të ankandit standard. Vetëm ankandi i marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes me maturim njëjavor është i tipit standard.

Diagramë 1. Etapat kohore të zhvillimit të ankandit standard.



b. Ankandi i shpejtë

Ankandet e shpejta zhvillohen për marrëveshjet (e anasjellta) e riblerjes me maturim njëditor, njëmuor dhe tremuor. Ato zhvillohen sa herë të gjykohet e nevojshme nga Banka e Shqipërisë, të paktën një orë më vonë nga njoftimi i Bankës së Shqipërisë.

c. Ankandet me çmim fiks dhe me shumë çmime

Banka e Shqipërisë operon me dy lloj ankandesh: ankande me çmim fiks dhe ankande me shumë çmime. Ankandi me çmim fiks nënkupton ankandin e marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes, të organizuar nga Banka e Shqipërisë, në të cilin plotësimi i kërkesave të pjesëmarrësve bëhet sipas interesit të marrëveshjeve të riblerjes, të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Ndërsa në ankandin me shumë çmime, plotësimi i kërkesave të pjesëmarrësve bëhet sipas interesit të marrëveshjes së riblerjes, të kërkuar nga bankat deri në plotësimin e shumës së shpallur nga Banka e Shqipërisë, por duke marrë në konsideratë që interesi i kërkuar nga bankat të jetë brenda lëvizjes së pranueshme të normës së interesit. Në ankandin me shumë çmime, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kufizojë pjesëmarrjen e bankave, nëpërmjet vendosjes së normës maksimale të pjesëmarrjes në ankand.

6.1.2 NJOFTIMI PËR ANKAND

Njoftimi që iu dërgohet bankave për organizimin e ankandëve (standarde ose të shpejta) të marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes përmban si rregull informacionin e mëposhtëm:

- numrin e ankandit;
- llojin e marrëveshjes (riblerjeje ose e anasjelltë riblerjeje);
- llojin e ankandit (me shumë çmime ose me çmim fiks);
- shumën e shpallur në vlerë nominale (në rast të ankandëve me shumë çmime);
- normën fikse të interesit riblerjes (në rast të ankandit me çmim fiks);
- datën dhe orën e ankandit;
- datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes;
- datën e përfundimit të marrëveshjes;
- të dhënat për letrën me vlerë (në rast të marrëveshjes së riblerjes) – llojin e letrës me vlerë, numrin e letrës me vlerë, datën e emetimit, datën e maturimit;
- normën e pjesëmarrjes.

6.1.3 PLOTËSIMI I KËRKESAVE PËR PJESËMARRJE NË ANKAND

Kërkesat e bankave për pjesëmarrje në ankandet e marrëveshjeve (të anasjellta)

të riblerjes duhet të përmbajnë si rregull informacionin e mëposhtëm:

- numrin e ankandit;
- llojin e marrëveshjes (riblerjeje/ e anasjelltë riblerjeje);
- datën e zhvillimit të ankandit;
- datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes;
- datën e përfundimit të marrëveshjes;
- shumën në vlerë nominale të pjesëmarrjes në ankand;
- interesin e riblerjes;
- të dhënat për letrën me vlerë - llojin e letrës me vlerë, numrin e letrës me vlerë, datën e emetimit, datën e maturimit;
- informacion për bankën pjesëmarrëse (në rast se kërkesa dërgohet me faks ose me shkresë zyrtare) ose kodin identifikues (në rast se kërkesa dërgohet me Reuters dhe SWIFT).

Kërkesat me mungesë informacioni dhe të paraqitura më vonë se afati i fundit i shpallur në njoftimin për ankand, nuk merren parasysh për pjesëmarrje në ankand.

6.1.4 PROCEDURAT PËR PRANIMIN E KËRKESAVE

a. Ankandi me çmim fiks

Në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes me çmim fiks, bankat cilësojnë shumën e pjesëmarrjes në ankand. Komisioni i organizimit të ankandit, llogarit kërkesën totale të bankave, duke u paguar bankave ose duke përfituar nga to (sipas tipit të marrëveshjes - riblerjeje apo e anasjelltë riblerjeje) interesin, të llogaritur me normën fikse të interesit të marrëveshjes së riblerjes, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Në këtë rast të gjitha kërkesat e pranuar për pjesëmarrjen në ankand shpallen fituese.

b. Ankandi me shumë çmime

Në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes ose të anasjellta të riblerjes me shumë çmime, bankat saktësojnë në kërkesat e tyre normën e interesit dhe shumën që ato kërkojnë. Në rastin e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, bankat pjesëmarrëse në ankand, që kërkojnë normë interesi më të lartë/më të ulët se norma maksimum/minimum e publikuar nga Banka e Shqipërisë skualifikohen automatikisht. Bankat kanë të drejtë të paraqitin deri në 5 kërkesa, me interes të ndryshëm riblerjeje.

Në varësi të marrëveshjes, riblerjeje ose anasjelltë riblerje, kërkesat rradhiten respektivisht në mënyrë rritëse ose zbritëse sipas interesit të riblerjes, që bankat

kanë paraqitur deri në plotësimin e shumës së shpallur nga Banka e Shqipërisë. Edhe në rastet kur shuma e kërkuar nga bankat është më e vogël ose e barabartë me shumën e ofruar nga Banka e Shqipërisë, kjo e fundit rezervon të drejtën të mos pranojë kërkesat e devijuara nga interesi i tregut.

Në rast se dy ose më shumë kërkesa kanë interes të barabartë riblerjeje, atëherë për shpërndarjen e kërkesave deri në plotësimin e shumës së shpallur nga Banka e Shqipërisë, aplikohet *prorata*. *Prorata* aplikohet në mënyrë uniforme për të gjitha kërkesat me interes të barabartë riblerjeje.

6.1.5 NJOFTIMI PËR REZULTATET E ANKANDIT

Pas përfundimit të ankandit, Banka e Shqipërisë njofton bankat pjesëmarrëse për rezultatet e tij. Ky njoftim përmban informacionin e mëposhtëm:

- numrin e ankandit;
- llojin e marrëveshjes (riblerjeje ose e anasjelltë riblerjeje);
- datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes;
- datën e përfundimit të marrëveshjes;
- shumën e kërkuar në vlerë nominale;
- shumën e pranuar në vlerë nominale;
- interesin e kërkuar;
- interesin e pranuar;
- çmimin e blerjes së letrës me vlerë;
- çmimin e riblerjes së letrës me vlerë.

Përveç bankave pjesëmarrëse në ankand, njoftohen të gjitha bankat e sistemit. Njoftimi që u dërgohet bankave të sistemit përmban si rregull informacionin e mëposhtëm:

- numrin e ankandit;
- llojin e marrëveshjes (riblerjeje ose e anasjelltë riblerjeje);
- datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes;
- datën e përfundimit të marrëveshjes;
- numrin e kërkesave;
- numrin e kërkesave të pranuar;
- shumën e kërkuar në vlerë nominale;
- shumën e pranuar në vlerë nominale;
- normën fikse të interesit të riblerjes (në rast të ankandit me çmim fiks);
- normën e ponderuar të interesit të riblerjes të kërkuar;
- normën e ponderuar të interesit të riblerjes së pranuar;
- normën minimum të interesit të riblerjes të kërkuar;
- normën minimum të interesit të riblerjes të pranuar;

- normën maksimum të interesit të riblerjes të kërkuar; dhe
- normën maksimum të interesit të riblerjes të pranuar.

6.2 REALIZIMI I MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLTA TË RIBLERJES NËPËRMJET PROCEDURAVE DYPALËSHE

Realizimi i ndërhyrjeve në tregun e parasë me marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes nëpërmjet procedurave dypalëshe, kryhet duke kontaktuar jo më pak se 3(tre) banka deri në plotësimin e shumës së shpallur nga Banka e Shqipërisë. Bankat me të cilat do të realizohet ndërhyrja, krahas përmbushjes së kriterëve për të qenë partner i bankës qendrore në realizimin e marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes, përzgjidhen edhe në bazë të strukturës të shpërndarjes së likuiditetit të sistemit bankar, aktivizimit të tyre në tregun ndërbankar të parasë; kuotimeve të publikuara për huamarrjen/huadhënien e fondeve me të njëjtin maturim si marrëveshja e riblerjes dhe e anasjelltë e riblerjes, me të cilën realizohet ndërhyrja në tregun e parasë.

Ndërhyrja në tregun e parasë me marrëveshje të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes që realizohet nëpërmjet procedurave dypalëshe, si rregull, nuk njoftohet paraprakisht nga Banka e Shqipërisë.

Në përfundim të ndërhyrjes me procedura dypalëshe, Banka e Shqipërisë publikon rezultatin agregat. Ky publikim përmban:

- llojin e marrëveshjes (riblerjeje ose të anasjelltë riblerjeje);
- datën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes;
- datën e përfundimit të marrëveshjes;
- vlerën monetare totale në vlerë nominale të marrëveshjes së realizuar (shumën totale të marrëveshjes); dhe
- normën e ponderuar të interesit të riblerjes.

6.3 PROCEDURAT PËR TRANSAKSIONET E SHITBLERJEVE ME TË DREJTA TË PLOTA

Transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota mund të ekzekutohen nëpërmjet ankandëve të shpejta ose nëpërmjet procedurave dypalëshe. Procedurat e ankandëve të shpejta për këto lloj transaksionesh janë të njëjta me ankandet e shpejta për marrëveshjet (e anasjellta) e riblerjes. Ndryshim

përmban vetëm njoftimi për ankand, i cili në rastin e transaksioneve me të drejta të plota nuk përmban asnjë lloj norme interesi, pasi interesi është i negociueshëm në bazë të afatit të maturimit të letrës me vlerë dhe nivelit të interesave të tregut.

Si rregull, njoftimi për ankandin e shitblerjeve me të drejta të plota përmban të dhënat e mëposhtme:

- numrin referues të ankandit;
- tipin e ankandit (shitje ose blerje);
- datën dhe orën e mbajtjes së ankandit;
- vlerën nominale të bonove të thesarit që ofrohet/kërkohe për t'u shitur/blerë;
- afatin fillestar të maturimit të letrave që blihen/shiten;
- të dhënat e letrës(ave) që ofrohet(en) për shitje (vetëm në rastin e shitjes me të drejta të plota).

Në rastin e kryerjes së transaksioneve të shitblerjeve me të drejta të plota nëpërmjet procedurave dypalëshe, Banka e Shqipërisë njofton me anë të mjeteve të komunikimit bankën me të cilën synon të operojë. Nëse banka bie dakord të hyjë në transaksion, ajo i dërgon menjëherë njoftim Bankës së Shqipërisë. Më pas, të dyja palët përcaktojnë dhe bien dakord për termat përkatës të transaksionit.

6.4 PASTRIMI I LLOGARIVE

Pastrimi i llogarive për marrëveshjet (e anasjellta) e riblerjes, të kryera nëpërmjet ankandit standard, bëhet ditën vijuese të ankandit (T+1). Ndërsa, për marrëveshjet (e anasjellta) e riblerjes të kryera nëpërmjet ankandit të shpejtë, nuk ka ndonjë ditë standarde të përcaktuar për pastrimin e llogarive nga dita e ankandit. Megjithatë, është e detyrueshme që kjo ditë të përcaktohet brenda kohëzgjatjes të realizimit të ndërhyrjes, kohëzgjatje e cila përcaktohet me vendim të Komitetit të Zbatimit të Politikës Monetare.

Për transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota, kalimi i veprimeve bëhet ditën e zhvillimit të ankandit ose të marrëveshjes dypalëshe. Pastrimi i llogarive përfshin transferimin e të drejtës së pronësisë së bonove të thesarit si dhe lëvizjen e fondeve përkatëse në llogari të Bankës së Shqipërisë dhe të bankave pjesëmarrëse në këto transaksione.

Tabelë 4. Dita e pastrimit të llogarive për operacionet e tregut të hapur.

Lloji i instrumentit	Dita e pastrimit të llogarive
Marrëveshje riblerjeje me maturim njëjavor	T + 1
Marrëveshje riblerjeje me maturim njëditor, njëmuor dhe tremujor	E papërcaktuar por maksimalisht brenda kohëzgjatjes së ndërhyrjes e cila përcaktohet nga KZPM
Transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota	T

7. GARANCITË E OPERACIONEVE KREDITUESE DHE VLERËSIMI I TYRE

Operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë ku përfshihen kredia brenda ditës, kredia njëditore, kredia lombard dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes garantojnë nëpërmjet vendosjes së kolateralit në rastin e kredive ose transferimit të së drejtës të pronësisë, në rastin e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes.

7.1 AKTIVET QË MUND TË PËRDOREN SI GARANCI

Aktivitet që shërbejnë si garanci për operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë janë letra me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe që përmbushin kriteret e mëposhtme:

- të jenë të tregtueshme në tregun sekondar të letrave me vlerë;
- të jenë të transferueshme dhe të depozitohen në një llogari të letrave me vlerë në Bankën e Shqipërisë deri në momentin e shlyerjes së kredisë;
- të kenë afat të mbetur deri në maturim jo më pak se 14 ditë, nga dita e shlyerjes së kredisë së marrë në Bankën e Shqipërisë.

7.2 VLERËSIMI I GARANCIVE

Me synim mbrojtjen e Bankës së Shqipërisë nga rreziku financiar, rritjen e efektivitetit operacional dhe transparencës, si dhe trajtimin e barabartë të të gjithë pjesëmarrësve në këto operacione, Banka e Shqipërisë ka vendosur disa kritere për vlerësimin e garancive të operacioneve të saj kredituese.

Vlerësimi i letrave me vlerë, bëhet mbi baza javore, nëse operacionet për të cilat letrat me vlerë që përdoren si garanci kanë maturim më tepër se shtatë ditë

ndërsa për operacionet për të cilat letrat me vlerë që përdoren si garanci kanë maturim njëditor, vlerësimi bëhet në bazë ditore.

Masat për kontrollin e rrezikut përshkruhen në tabelën 5, ndërkohë që vlerat aktuale të këtyre masave jepen në tabelën 6.

7.3 MASAT PËR KUNDËRVAJTJEN E BANKAVE NË LIDHJE ME PLOTËSIMIN E KËRKESAVE PËR VENDOSJEN DHE RUAJTJEN E NIVELIT TË GARANCISË

Në rast se kredia e marrë nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet çfarëdolloj operacioni nuk kthehet në kohë, kolaterali kalon në pronësi të Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë gjithashtu, ka të drejtë të ndërmarrë sanksione ndaj bankave në rast se këto të fundit nuk plotësojnë kërkesat për vendosjen dhe ruajtjen e nivelit të garancisë. Një prej masave që mund të merret është vendosja e gjobës mbi shumën e mosplotësimit të garancisë, llogaritur me interes gjobë normën e kredisë lombard plus 5 pikë për qind për kohëzgjatjen e mbetur të operacionit kreditues, për të cilin është vendosur garancia. Më tej mund të ndërmerren masa të tjera, sipas përcaktimeve në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Tabelë 5. Masat për kontrollin e rrezikut.

Banka e Shqipërisë aktualisht aplikon masat e mëposhtme për kontrollin e rrezikut:

Marzhi fillestar.

Në përmbushjen e operacioneve të saj kredituese Banka e Shqipërisë kërkon që garancia e vendosur nga banka të jetë e barabartë me shumën e kredisë së akorduar bankës, plus një përqindje të caktuar. Kjo përqindje e caktuar është marzhi fillestar.

Diferencimi i përqindjeve (i marzheve fillestare) bëhet në përputhje me kohëzgjatjen e operacionit kreditues (shih tabelën 3).

Marzhi reduktues

Marzhi reduktues i referohet përqindjes së caktuar që i zbritet vlerës së tregut të letrës me vlerë. Kjo përqindje reflekton karakteristikat e letrës me vlerë, të tilla si maturimi i mbetur.

Marzhi i ruajtjes së vlerës së tregut

Banka e Shqipërisë kërkon që vlera e tregut e garancisë të axhustuar me marzhin reduktues, të ruhet gjatë kohëzgjatjes së operacioneve kredituese të Bankës së Shqipërisë. Kjo nënkupton, që në rast se vlera e tregut e letrës me vlerë matur në intervale të përcaktuara kohore brenda kohëzgjatjes së operacionit kreditues, bie nën një 'nivel të caktuar', Banka e Shqipërisë i kërkon bankës të depozitohet vlerë shtesë të letrës me vlerë (ose letër tjetër), deri në plotësimin e vlerës së garancisë që përkon me shumën e kredisë me marzhin fillestar. 'Niveli i caktuar', në këtë rast është i barabartë me diferencën e kredisë së axhustuar me marzhin fillestar me prodhimin e kësaj të fundit, me marzhin e ruajtjes së vlerës së tregut të shprehur në përqindje. (Shih aneksi 1/shembulli 4.) Marzhi i ruajtjes së vlerës së tregut aplikohet në mënyrë simetrike, që do të thotë se në rast se rritet mbi nivelin e caktuar, që në këtë rast llogaritet si shumë e kredisë së axhustuar me marzhin fillestar me prodhimin e kësaj të fundit me marzhin e ruajtjes së vlerës së tregut, atëherë banka ka të drejtë t'i kërkojë Bankës së Shqipërisë pjesën e tepërt të letrës me vlerë, të vendosur si garanci.

Fomula përmbledhëse:

$$L * (1 + In) = \frac{Vn}{1 + \frac{i}{365} * d} * (1-H)$$

ku

L - Likuiditeti i kredituar bankës nga Banka e Shqipërisë;

In - Marzhi fillestar;

Vn - Vlera nominale e letrës me vlerë;

i - Interesi i tregut (i përshtatur me ditët në maturim të letrës me vlerë);

H - Marzhi reduktues;

d - Ditët në maturim të letrës me vlerë.

Në qoftë se ana e djathtë e barazimit bie në nivelin e përfituar nga:

$$L * (1 + In) - Mr * L * (1 + In)$$

ku

Mr - Marzhi i ruajtjes së vlerës së tregut.

atëherë Banka e Shqipërisë kërkon shtesë të letrave me vlerë deri sa barazimi të përfitohet përsëri.

Tabelë 6. Vlerat e masave të kontrollit të rrezikut.

Masat e kontrollit të rrezikut	MATURIMI (KOHËZGJATJA) I(E) OPERACIONIT KREDITUES	
	Njëditor	> Njëditor
Marzhi fillestar	8%	10%
Marzhi reduktues		
Maturimi i mbetur i letrës me vlerë < 1 vit	3%	3%
Maturimi i mbetur i letrës me vlerë > 1 vit	6%	6%
Marzhi i ruajtjes së vlerës së tregut	3%	3%

8. REZERVA E DETYRUAR

8.1 TË PËRGJITHSHME

Rezerva e detyruar është instrument i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, e cila synon rregullimin e likuiditetit në sistemin bankar dhe stabilizimin e normave të interesit në tregun e parasë.

Shuma e rezervës minimale mbajtur nga çdo bankë përcaktohet në varësi të bazës së rezervës duke aplikuar normën e rezervës së detyruar. Kjo normë është e njëjtë si për detyrimet në lekë edhe për detyrimet në valutë.

Sistemi i rezervës së detyruar i aplikuar nga Banka e Shqipërisë i lejon bankat të përdorin një nivel të caktuar të rezervës në bazë ditore, duke vendosur detyrimin e mbajtjes së nivelit mesatar mujor të rezervës minimale të detyruar jo më të vogël se niveli i rezervës së detyruar, e matur kjo në ditën e fundit të periudhës së mbajtjes. Rezervat e detyruara në lekë të bankave, remunerohen me një normë që përcaktohet me bazë normën e marrëveshjeve të riblerjeve me maturim njëjavor, ndërsa rezervat e detyruara në valutë remunerohen me një normë që lidhet me normën bazë të Bankës Qendrore Evropiane dhe Bankës Federale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

8.2 PËRCAKTIMI I MINIMUMIT TË REZERVËS SË DETYRUAR

8.2.1 BAZA E REZERVËS

Baza e rezervës përfshin detyrimet që rezultojnë nga pranimi i fondeve nga bankat, të pasqyruara në bilancin kontabël të tyre, në lekë dhe në valutë. Baza e rezervës në valutë përbëhet nga detyrimet në dollarë dhe detyrimet në euro, ku detyrimet në euro krahas detyrimeve në monedhën e përbashkët përshijnë të

gjitha detyrimet në monedha të tjera përveç dollarit, të konvertuara me kursin fiks të Bankës së Shqipërisë në ditën e fundit të periudhës bazë.

Për bankat subjekt i rezervës së detyruar, të dhënat e bilancit referuar fundit të një muaji kalendarik (periudhës bazë) përdoren për të përcaktuar bazën e rezervës për periudhën e mbajtjes, që fillon gjatë muajit pasues kalendarik.

Të dhënat e bilancit kontabël raportohen në Bankën e Shqipërisë sipas frekuencës, sipas formatit dhe sipas afateve të përcaktuara brenda kuadrit të raportimit statistikor.

8.2.2 NORMA E REZERVËS DHE LLOGARITJA E REZERVËS

Norma e rezervës së detyruar është përqindja e bazës së rezervës së detyruar, e cila mbahet në Bankën e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë mund të ndryshojë në çdo kohë normën e rezervës së detyruar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të saj. Ndryshimet në normën e rezervës njoftohen nga Banka e Shqipërisë 30 ditë përpara fillimit të periudhës së mbajtjes të rezervës së detyruar.

Niveli i rezervës së detyruar që secila nga bankat mban gjatë periudhës së mbajtjes, llogaritet duke aplikuar normën e rezervës së detyruar për çdo kategori të detyrimeve të përfshira në bazën e rezervës.

Tabelë 7. Baza dhe norma e rezervës së detyruar.


Norma e rezervës së detyruar	Zërat e bilancit kontabël të përfshirë në rezervën e detyruar						
	Detyrime ndaj klientëve për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat					Letra me vlerë të blera dhe të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes	
	Llogari rrjedhëse	Llogari depozitash pa afat	Llogari depozitash me afat		Certifikatat e depozitave		Letra me vlerë të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes
			<2 vjet	>2 vjet	<2 vjet	>2 vjet	
	10%	10%	10%	0%	10%	0%	0%

8.2.3 MBAJTJA E REZERVËS SË DETYRUAR

Bankat mbajnë rezervën e detyruar në llogaritë e tyre rezervë në lekë dhe në valutë (në euro dhe në dollarë amerikanë) në Bankën e Shqipërisë.

Periodha e mbajtjes së rezervës së detyruar është 1 (një) muaj. Ajo fillon nga dita e 24-të e muajit që pason periudhën bazë dhe përfundon në ditën e 23-të të muajit pasues.

Diagramë 2. Funksionimi i rezervës së detyruar në lekë.



8.2.4 PËRDORIMI I REZERVËS SË DETYRUAR

Gjatë periudhës së mbajtjes, bankat kanë të drejtë të përdorin vetëm rezervën e detyruar në lekë, me kusht që mesatarja e gjendjes së llogarisë rezervë ditën e fundit të periudhës së mbajtjes, të mos jetë nën nivelin e rezervës së detyruar.

Masa e rezervës së detyruar, e cila mund të përdoret në një ditë nga bankat shprehet në përqindje të rezervës së detyruar dhe përcaktohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë si dhe njoftohet të paktën 30 (tridhjetë) ditë pune përpara fillimit të periudhës së mbajtjes. Aktualisht, masa e përdorimit është 40 për qind e rezervës së detyruar.

8.2.5 REMUNERIMI I REZERVËS SË DETYRUAR

Banka e Shqipërisë, për periudhën e mbajtjes së minimumit të rezervës së detyruar të bankave, në lekë dhe në valutë, u paguan bankave interesa në llogaritë përkatëse në Bankën e Shqipërisë (tabela 8). Interesi për remunerimin e

rezervës së detyruar kalohet në llogaritë rezervë të bankave, në ditën pasardhëse të ditës së fundit të periudhës së mbajtjes të rezervës së detyruar.

Tabelë 8. Llogaritja e remunerimit të rezervës së detyruar.

Llogaritja e remunerimit të rezervës së detyruar bëhet në bazë të formulave të mëposhtme:

a. rezerva e detyruar në lekë

$$I = \frac{RD * NI * d}{365}$$

b. rezerva e detyruar në valutë

$$I = \frac{RD * NI * d}{360}$$

Ku:

- I - interesi i paguar për remunerimin e rezervës së detyruar për periudhën e mbajtjes;
- RD - niveli i rezervës së detyruar për periudhën e mbajtjes të rezervës së detyruar;
- NI - norma e remunerimit të rezervës së detyruar;
- d - kohëzgjatja e periudhës të mbajtjes të rezervës së detyruar, e shprehur në ditë.

Normat e remunerimit të rezervës së detyruar në lekë dhe në valutë përkatësisht, përcaktohen me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe njoftohen të paktën 30 (tridhjetë) ditë pune, përpara fillimit të periudhës së mbajtjes.

Aktualisht, rezerva e detyruar në lekë remunerohet me normë interesi 70 për qind të normës bazë të marrëveshjeve të riblerjes me maturim njëjavor. Rezerva e detyruar në euro remunerohet me normë interesi 70 për qind të normës bazë të Bankës Qendrore Evropiane. Rezerva e detyruar në dollarë amerikanë remunerohet me normë interesi 70 për qind të normës bazë të Bankës Federale të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Niveli i normave bazë referencë të përmendura më lart, përkon me nivelin e tyre në ditën e fundit të periudhës bazë.

8.2.6 RAPORTIMI I BAZËS SË REZERVËS SË DETYRUAR

Raportimi i të dhënave bëhet sipas formatit, sipas frekuencës dhe sipas afateve të përcaktuara. Data e fundit e raportimit të rezervës së detyruar është data 15 e çdo muaji. Saktësia e raportimit të bankës kontrollohet nga Banka e Shqipërisë.

8.2.7 SANKSIONET PËR MOSPLOTËSIMIN E REZERVËS SË DETYRUAR

Detyrimet nga mosplotësimi i minimumit të rezervës së detyruar vijnë nëse:

a) gjendja mesatare e llogarisë rezervë në lekë të bankës, gjatë periudhës së mbajtjes, është më e vogël se rezerva e detyruar për të njëjtën periudhë korresponduese;

Tabelë 9. Llogaritja e gjobës për mosplotësimin e rezervës së detyruar në lekë.

$$I_{gj} = \frac{\left[\frac{\sum GJL}{d} - RD \right] * N I_{gj} * d}{365}$$

Ku:

I_{gj} - interesi gjobë i aplikuar;

GJL - gjendja ditore e llogarisë rezervë në lekë gjatë periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar;

RD - niveli i rezervës së detyruar për periudhën e mbajtjes të rezervës së detyruar;

d - kohëzgjatja e periudhës të mbajtjes të rezervës së detyruar, e shprehur në ditë;

$N I_{gj}$ - norma e interesit gjobë.

b) në ditën e parë të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar në euro dhe/ose në dollarë amerikanë, gjendja e llogarisë rezervë të bankës sipas monedhave përkatëse është më e vogël se niveli i rezervës së detyruar;

Tabelë 10. Llogaritja e gjobës për mosplotësimin e rezervës së detyruar në valutë.

$$lgj = \frac{(GJL - RD) * Nlgj * d}{360}$$

Ku:

lgj - interesi gjobë i aplikuar;

GJL - gjendje e llogarisë rezervë të bankës në euro dhe/ose në dollarë amerikanë në ditën e parë të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar;

RD - niveli i rezervës së detyruar për periudhën e mbajtjes të rezervës së detyruar;

Nlgj - norma e interesit gjobë;

d - kohëzgjatja e periudhës së mosplotësimit të rezervës së detyruar, e shprehur në ditë.

c) pas periudhës së mbajtjes së rezervës, verifikohet mospërputhja në vlerë monetare më shumë se 1,000 (një mijë) lekë (ose ekuivalenca e shumës në euro dhe në dollarë) e të dhënave të raportuara për rezervën e detyruar me të dhënat e bilancit kontabël të raportuar dhe/ose me të dhënat e marra nga inspektimet në vend të bankës;

Tabelë 11. Llogaritja e gjobës për raportimin e gabuar të rezervës së detyruar.

1. Për raportimin e rezervës së detyruar në nivel më të ulët, aplikohet gjobë sipas formulës:

$$lgj = \frac{(RDs - RDg) * Nlgj * d}{vk}$$

Ku:

lgj - interesi gjobë i aplikuar;

RDs - niveli i saktë, i verifikuar i rezervës së detyruar (në lekë, euro, dollarë amerikanë);

RDg - niveli i raportuar gabim i rezervës së detyruar (në lekë, euro, dollarë amerikanë);

Nlgj - norma e interesit gjobë;

d - kohëzgjatja e periudhës të mbajtjes të rezervës së detyruar, e shprehur në ditë;

vk - viti kalendarik; 365 ditë për rezervën e detyruar në lekë dhe 360 ditë për rezervën e detyruar në valutë.

2. Për raportimin e rezervës së detyruar në nivel më të lartë, banka është e detyruar t'i kthejë Bankës së Shqipërisë interesin e përfituar nga remunerimi i shtesës të rezervës së raportuar.

d) banka nuk raporton brenda afatit të përcaktuar, atëherë niveli i rezervës së detyruar përcaktohet në masën 10 (dhjetë) për qind më i lartë se niveli i rezervës së detyruar të bankës në raportimin e fundit të saj, por jo më i lartë se 700 milionë lekë (ose ekuivalenca e kësaj shume në euro dhe në dollarë). Në rast se niveli faktik por i paraportuar i rezervës së detyruar, i verifikuar nga Banka e Shqipërisë pas fillimit të periudhës së mbajtjes, rezulton më i lartë se niveli i përcaktuar më lart, atëherë bankës i vendoset detyrimi për raportim të gabuar, i njëjtë si në tabelën 11.

Tabelë 12. Normat e interesit gjorbë, të aplikuara për kundërvajtje me rregullat e mbajtjes së rezervës së detyruar.

Norma e interesit gjorbë për kundërvajtjet me rregullat për mbajtjen e rezervës së detyruar në LEKË	Norma e interesit gjorbë për kundërvajtjet me rregullat për mbajtjen e rezervës së detyruar në DOLLARË AMERIKANË	Norma e interesit gjorbë për kundërvajtjet me rregullat për mbajtjen e rezervës së detyruar në EURO
600 (gjashtëqind) pikë bazë më i lartë se norma bazë e interesit të Bankës së Shqipërisë në ditën e fundit të periudhës bazë, por jo më i lartë se dyfishi i normës bazë të Bankës së Shqipërisë	200 (dyqind) pikë më i lartë se norma bazë e interesit të Bankës Federale të SHBA në ditën e fundit të periudhës bazë, por jo më i lartë se dyfishi i normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë.	200 (dyqind) pikë më i lartë se norma bazë e interesit të Bankës Qendrore Evropiane në ditën e fundit të periudhës bazë, por jo më i lartë se dyfishi i normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë

Krahas vendosjes së gjobave me karakter financiar, çdo veprim i bankave në kundërvajtje me rregulloren e rezervës së detyruar përbën shkelje të dispozitave të ligjit për bankat dhe është subjekt i sanksioneve të tjera të parashikuara në këtë ligj.

ANEKSI 1. SHEMBUJ TË REALIZIMIT TË DISA PREJ OPERACIONEVE MONETARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Shembull 1. Marrëveshje e anasjelltë riblerjeje me maturim njëjavor, e realizuar nëpërmjet ankandit standard me shumë të shpallur.

Banka e Shqipërisë njofton ankandin për të lidhur marrëveshje të anasjelltë riblerjeje me maturim njëjavor me shumë të shpallur 2 miliardë lekë, që do të thotë që Banka e Shqipërisë ble nga bankat bono thesari me vlerë nominale 2 miliardë lekë, me të drejtë për të shitur (riblerë nga bankat) pas një jave, këtë vlerë nominale të bonove të thesarit. Kërkesat e bankave janë si më poshtë të renditura në rendin zbritës, duke marrë për bazë normën e interesit të kërkuar nga bankat:

Tabelë A. Kërkesat e bankave në ankandin e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim njëjavor.

Interesi i riblerjes (%)	Shuma (në milionë lekë)					
	Banka 1	Banka 2	Banka 3	Banka 4	Shuma e kërkesave	Shuma kumulative e kërkesave
	TB20022009	TB04082009	TB15122008	TB20022009		
6.40%	400				400	400
6.38%		300	100		400	800
6.35%	200		200		400	1200
6.30%			400	200	600	1800
6.25%			50	400	450	2250

Banka e Shqipërisë do të pranojë shumën e shpallur 2 miliardë lekë. Duke qenë se ka dy kërkesa (Banka 3 dhe Banka 4) me të njëjtin interes 6.25% (që është interesi më i ulët me të cilin Banka e Shqipërisë do të injektojë likuiditet kundrejt blerjes së bonove të thesarit), shpërndarja e kërkesave fituese do të bëhet në bazë të proratës si më poshtë:

$$\text{Proratë} = \frac{2000 - 1800}{450} = 0.44$$

Kërkesa fituese për Bankën 3 : $0.44 \cdot 50 = 22$ milionë lekë; Kërkesa totale fituese të kësaj banke do të jenë 722 milionë lekë.

Kërkesa fituese për Bankën 4: $0.44 \cdot 400 = 178$ milionë lekë; Kërkesat totale fituese të kësaj banke do të jenë 378 milionë lekë.

Interesi i ponderuar i riblerjes, i kërkesave të shpallura fituese është 6.34%, ndërsa i kërkesave fillestare është 6.33%.

Çmimi i blerjes së letrës me vlerë, i azhustuar për masat e kontrollit të rrezikut është likuiditeti që marrin bankat nëpërmjet lidhjes së marrëveshjes së anasjelltë të riblerjes me Bankën e Shqipërisë. Duke zgjidhur për L-formulën e paraqitur në tabelën 5, likuiditeti i përfituar nga bankat do të jetë si më poshtë:

Tabelë B. Llogaritja e çmimit të blerjes dhe riblerjes në marrëveshjet e anasjellta të riblerjes.

Banka	Letra me vlerë	Ditët në maturim	Vlera nominale (milionë lekë)	Interesi i tregut	Marzhi reduktues	Marzhi fillestar	Çmimi i blerjes (milionë lekë)	Interesi i riblerjes	Çmimi i riblerjes (milionë lekë)
Banka 1	TB20022009	193	400	7.10%	3%	10%	339.96*	6.40%	340.38
Banka 2	TB04082009	358	300	8.05%	3%	10%	245.19	6.38%	245.49
Banka 3	TB15122008	126	100	6.80%	3%	10%	86.16	6.38%	86.26
Banka 1	TB20022009	193	200	7.10%	3%	10%	169.98	6.35%	170.19
Banka 3	TB15122008	126	200	6.80%	3%	10%	172.32	6.35%	172.53
Banka 3	TB15122008	126	400	6.80%	3%	10%	344.64	6.30%	345.05
Banka 4	TB20022009	193	200	7.10%	3%	10%	169.98	6.30%	170.19
Banka 3	TB15122008	126	22	6.80%	3%	10%	18.96	6.25%	18.98
Banka 4	TB20022009	193	178	7.10%	3%	10%	151.28	6.25%	151.47
Total			2000				1,698.47		1,700.53

* Duke zgjidhur për L formulën e paraqitur në tabelën 5, atëherë likuiditeti i përfituar nga Banka 1 nëpërmjet kërkesës së saj prej 400 milionë lekë, në vlerë nominale do të jetë:

$$1 + \frac{\frac{400}{7.10\%} \cdot (1-3\%) - 365}{(1 + 10\%)} \cdot 193 = 339.96 \text{ milionë lekë}$$

Rrjedhimisht, likuiditeti që injekton Banka e Shqipërisë nëpërmjet lidhjes së kësaj marrëveshjeje të anasjelltë riblerjeje me vlerë nominale 2 miliardë lekë, është 1.698 miliardë lekë (çmimi i blerjes), ndërsa interesi që i detyrohen bankat pjesëmarrëse Bankës së Shqipërisë është diferenca midis çmimit të riblerjes dhe çmimit të blerjes ose përafërsisht 2 milionë lekë.

Organizimi i ankandit të marrëveshjeje të anasjellta me çmim fiks, ka këto ndryshime në procedura:

1. Të gjitha kërkesat do të pranohen për sa kohë ato plotësojnë të dhënat e kërkuara sipas përshkrimit në paragrafin 6.1.3.
2. Norma e riblerjes do të jetë e njëjtë për të gjitha kërkesat.

Duke qenë se shembulli 1 është për marrëveshjet e anasjellta të riblerjes me maturim një javor, vlerësimi i garancisë bëhet në fillim dhe nuk ka rivlerësime gjatë periudhës njëjavore. Një shembull se si vlerësohen garancitë për operacionet kredituese me afat më të gjatë dhe si mund të aplikohen marzhet e ruajtjes të vlerës së tregut paraqitet në shembullin 4.

Shembull 2. Marrëveshje e riblerjes me maturim tremujor e realizuar nëpërmjet ankandit të shpejtë, me shumë të shpallur.

Tabelë C. Kërkesat e bankave në ankandin e marrëveshjeve të riblerjes me maturim tremujor.

Interesi i riblerjes (%)	Shuma (në milionë lekë)					
	Banka 1	Banka 2	Banka 3	Banka 4	Shuma e kërkesave	Shuma kumulative e kërkesave
	TB20022009*	TB20022009	TB20022009	TB20022009		
6.26%	400				400	400
6.28%		300	70		370	770
6.30%	200		50		250	1020
6.31%			500		500	1520
6.90%				400	400	1920

* Bono e thesarit që Banka e Shqipërisë ka njoftuar për shitje. Banka e Shqipërisë mund të shesë më shumë se një letër nga portofoli i saj. Në çdo rast bankat duhet të specifikojnë letrën që kërkojnë të blenë nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të riblerjes me Bankën e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë njofton ankandin për të lidhur marrëveshje riblerjeje me maturim tremujor me shumë të shpallur 2 miliardë lekë, që do të thotë që Banka e Shqipërisë shet nga portofoli i saj, bono thesari me vlerë nominale 2 miliardë lekë me të drejtë riblerjeje pas tre muajve. Kërkesat e bankave janë si më poshtë, të renditura në rendin rritës duke marrë për bazë normën e interesit të kërkuar nga bankat:

Siç vihet re nga tabela më sipër ky ankand nuk është plotësuar, pasi kërkesa e bankave ka qenë për 1.92 miliardë lekë nga 2 miliardë lekë të shpallur nga Banka e Shqipërisë.

Interesi i ponderuar i kërkesave llogaritet të jetë 6.42%.

Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën të mos pranojë kërkesat e devijuara nga interesi i tregut. Ky vendim, merret duke pasur në konsideratë interesin e tregut, kuotimet e bankave në tregun ndërbankar për marrëveshjet me të njëjtin maturim (3-mujor), interesin e ponderuar të veprimeve në tregun ndërbankar për transaksionet për të njëjtin maturitet si dhe synimet e Bankës së Shqipërisë në realizimin e këtij ankandi.

Për shembull, në kushtet kur interesi bazë i Bankës së Shqipërisë është 6.25% dhe *yield*-i 3-mujor i bonove të thesarit është 6.27%, kërkesa e Bankës 4 me interes riblerjeje 6.90% konsiderohet si e devijuar nga interesi i tregut. Megjithatë, ky rast është vetëm një shembull pasi lëvizja e pranueshme e interesit të kërkuar nga bankat me interesin e tregut, në varësi të kushteve monetare dhe synimeve të Bankës së Shqipërisë, mund të ketë madhësi të ndryshme.

Duke iu kthyer përsëri shembullit, Banka e Shqipërisë vendos të mos pranojë kërkesën e Bankës 4. Rrjedhimisht, shuma e pranuar është 1.52 miliardë lekë me interes riblerjeje të ponderuar 6.29%.

Në ndryshim me rastin e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes, çmimi i blerjes së letrës me vlerë nuk axhustohet me masat e kontrollit të rrezikut, pasi Banka e Shqipërisë nuk mbart rrezik krediti. Llogaritjet për ankandin e marrë shembull vijojnë më poshtë:

Tabelë D. Llogaritja e çmimit të blerjes dhe riblerjes në marrëveshjet e anasjellta të riblerjes.

Banka	Letra me vlerë	Ditët në maturim	Vlera nominale (në milionë lekë)	Interesi i tregut	Çmimi i blerjes (në milionë lekë)	Interesi i riblerjes	Çmimi i riblerjes (milionë lekë)
Banka 1	TB20022009	193	400	7.10%	385.53*	6.26%	391.54**
Banka 2	TB20022009	193	300	7.10%	289.14	6.28%	293.67
Banka 3	TB20022009	193	70	7.10%	67.47	6.28%	68.52
Banka 1	TB20022009	193	200	7.10%	192.76	6.30%	195.79
Banka 3	TB20022009	193	50	7.10%	48.19	6.30%	48.95
Banka 3	TB20022009	193	500	7.10%	481.91	6.31%	489.49
Total			1,520		1,465.00		1,487.97

$$* \text{Çmimi i blerjes} = \frac{400}{1 + \frac{7.10\%}{365} * 193} = 385.53 \text{ milionë lekë}$$

$$** \text{Çmimi i riblerjes} = 385.53 + (385.53 * 6.26\% * \frac{91}{365}) = 391.54 \text{ milionë lekë}$$

Nëpërmjet lidhjes së marrëveshjes së riblerjes me maturim tremujor me bankat, Banka e Shqipërisë shiti bono thesari nga portofoli i saj në vlerë nominale 1.52 miliardë lekë, duke tërhequr 1.465 miliardë lekë nga bankat me të drejtë riblerjeje me çmimin 1.487 miliardë lekë. Diferenca midis çmimit të blerjes dhe riblerjes (22.97 milionë lekë) është interesi që Banka e Shqipërisë iu paguan bankave në përfundim të marrëveshjes.

Shembull 3. Blerje me të drejta të plota e bonove të thesarit.

Banka e Shqipërisë njofton ankandin për blerjen me të drejta të plota të bonove të thesarit, në vlerë nominale 2 miliardë lekë. Në parim, i preferuar është interesi më i lartë i ofruar (çmimi më i ulët), por duke qenë se bankat mund të ofrojnë

për shitje bono të ndryshme thesari, si mënyrë krahasuese për të vlerësuar ofertat më të mira është diferenca nga interesi (çmimi) i tregut. Në tabelën e mëposhtme ilustruhet kjo mënyrë.

Tabelë E. Ankandi i blerjes me të drejta të plota.

Banka	Letra me vlerë	Ditët në maturim	Vlera nominale (milione lekë)	Interesi i ofruar nga banka	Interesi i tregut	Luhatja nga interesi i tregut	Pranuar	Çmimi i blerjes*
Banka 1	TB20022009	193	1000	7.20%	7.10%	0.10%	1,000.00	963.33
Banka 2	TB04082009	358	500	8.10%	8.05%	0.05%	500.00	463.20
Banka 3	TB15122008	126	700	6.75%	6.80%	-0.05%	500.00	488.61
Total			2200				2,000.00	1,915.14

* Formula është e njëjtë me ankandin e marrëveshjeve të riblerjes në shembullin 2/shënimi 3.

Banka 1 dhe Banka 2 kanë ofruar për të shitur bonot e tyre të thesarit me interes respektivisht 10 pikë dhe 5 pikë bazë më lart se interesi i tregut, ndërsa Banka 3 ka ofruar për shitje bonon e thesarit me interes 5 pikë poshtë interesit të tregut. Në rastin e ankandit për blerjen me të drejta të plota të bonove të thesarit, ofertat e bankave renditen në rendin zbritës duke u nisur nga diferenca më e lartë pozitive e krahasuar me interesin e tregut. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të refuzojë ofertat e bankave, interesat e të cilave janë përtej lëvizjes së pranuar nga interesi i tregut. Në rastin konkret, të gjitha ofertat deri në plotësimin e shumës së shpallur të Bankës së Shqipërisë janë pranuar. Nëpërmjet këtij ankandi Banka e Shqipërisë ble 2 miliardë lekë bono thesari duke injektuar në mënyrë të përhershme 1.915 miliardë lekë në sistemin bankar.

Në rastin e shitjes së bonove të thesarit nga Banka e Shqipërisë, kërkesat e bankave do të renditen në rendin zbritës, duke u nisur nga diferenca më e lartë negative e krahasuar me interesin e tregut, që do të thotë ofertat me interes më të ulët krahasuar me interesin e tregut renditen të parat.

Shembull 4: Vlerësimi i garancive për operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë.

Tabelë F. Vlerësimi i garancisë (bono thesari).

Periudha	Kredia lombard	Vlera e kredisë pas marzhit fillestar	Garancia	Vlera nominale	Interesi tregut	Vlera e tregut*	Vlera e tregut pas marzhit reduktues	Marzhi i ruajtjes së vlerës	Niveli i poshtëm	Niveli i sipërm
Dita e parë	100.00	110.00	TB20022009	118.00	7.10%	113.73	110.32	3.30	106.70	113.30
Java I	100.00	110.00	TB20022009	118.00	7.35%	113.74	110.33	3.30	106.70	113.30
Java II	100.00	110.00	TB20022009	118.00	14.90%	109.96	106.67	3.30	106.70	113.30
Java III	100.00	110.00	TB20022009	121.69	15.00%	113.66	110.25	3.30	106.70	113.30

* Formula e llogaritjes së vlerës së tregut është e njëjtë me formulën e llogaritjes së çmimit të blerjes. Shih shënimin 3. Bonoja e thesarit e marrë si shembull ditën e parë të vlerësimit ka 193 ditë të mbetura deri në maturim. Duke qenë se vlerësimi është javor, numri i ditëve të mbetura në maturim reduktohen me 7 ditë. Respektivisht në javën I, letra ka 186 ditë në maturim, javën II 179 ditë dhe javën III, 172 ditë.

Banka 1 kërkon kredi lombard nga Banka e Shqipërisë me maturim njëmuor në shumën 100 milionë lekë, kredi e cila pasi miratohet, akordohet kundrejt vendosjes së garancisë nga Banka 1. Vlerësimi i garancisë bëhet ditën e parë të vendosjes së saj dhe më pas në intervale javore.

Në ditën e parë të vlerësimit të garancisë duhet që vlera e kredisë e azhustuar me marzhin fillestar ($100 + 10\% \cdot 100$) që në rastin konkret është 110 milionë lekë, të jetë jo më e vogël se vlera e tregut e letrës me vlerë të vendosur si garanci e azhustuar me marzhin reduktues, që në rastin konkret ditën e parë të vlerësimit përkon me nivelin 110.32 milionë lekë ($113.73 - 3\% \cdot 113.73$).

Marzhi i ruajtjes së vlerës është aktualisht 3%, domethënë 3 për qind e vlerës së kredisë pas marzhit fillestar. Në rastin konkret 3.3 milionë lekë ($3\% \cdot 110$). Në qoftë se vlera e letrës me vlerë pas marzhit reduktues bie nën nivelin e poshtëm, banka detyrohet të sjellë garanci shtesë. Niveli i poshtëm llogaritet si diferencë e vlerës së kredisë së azhustuar pas marzhit fillestar me marzhin e ruajtjes së vlerës ($110 - 3.3 = 106.70$). Ndërsa niveli i sipërm është shumë e këtyre dy elementeve ($110 + 3.3 = 113.3$). Në rast se vlera e letrës me vlerë pas marzhit reduktues rritet mbi nivelin e sipërm me kërkesë të bankës, Banka e Shqipërisë i kthen bankës garancinë e tepërt.

Në vlerësimin e bërë në javën e dytë, rritja e interesit të tregut bën që vlera e letrës me vlerë pas marzhit reduktues të bjerë nën nivelin e poshtëm. Në këtë rast, banka detyrohet të sjellë garanci shtesë. Kjo garanci shtesë është e barabartë me marzhin e ruajtjes së vlerës plus pjesën e paplotësuar të garancisë deri në nivelin e poshtëm. Konkretisht:

3.3	+	(106.67	-	106.63)	=	3.34
marzhi i ruajtjes së vlerës		niveli i poshtëm		vlera pas marzhit reduktues		

Megjithatë, bankës i kërkohet të transferojë bono thesari të shprehur në vlerë nominale. Kjo vlerë nominale llogaritet:

$3.34 \cdot (1 + 3\%)$	*	$(1 + 14.80\% \cdot \frac{179}{365})$	=	3.69
Vlera e tregut e letrës me vlerë pas heqjes së efektit të marzhit reduktues		Veprimet për të kthyer vlerën e tregut në vlerë nominale (zgjidhja për Vn e formulës të paraqitur në tabelën 2). Interesi korrespondon me interesin e tregut në ditën e vlerësimit dhe ditët në maturim të letrës me vlerë		Vlera nominale që duhet të transferohet*

* Në rast se banka do të vendosë shtesën e nevojshme të garancisë duke sjellë një letër tjetër me vlerë atëherë vlera nominale e saj do të gjendet me të njëjtën formulë, në rast se letra me vlerë është bono thesari por e llogaritur me interesin përkatës të tregut sipas ditëve të mbetura deri në maturim të kësaj bonoje thesari.

Siç vihet re në tabelën F, vlera nominale e letrës me vlerë në javën e tretë të vlerësimit është 3.69 milionë lekë më e lartë se vlera nominale e garancisë fillestare të vendosur nga banka. Banka mund të shtojë vlerën nominale të letrës me vlerë fillestare të vendosur si garanci. Në rast se banka nuk ka në portofolin e saj nivelin e nevojshëm të letrës fillestare, ajo mund ta plotësojë garancinë me një letër tjetër me vlerë ose mund të ndryshojë garancinë duke vendosur një letër tjetër me vlerë, e cila kur vlerësohet (në bazë të interesit të tregut dhe ditëve të mbetura në maturim) dhe axhustohet me marzhin reduktues, të jetë të paktën e barabartë me vlerën e kredisë pas marzhit fillestar.

Deri tani është marrë në konsideratë vendosja si garanci për operacionet kredituese vetëm e bonove të thesarit. Por, bankat kanë të drejtë që përkundrejt marrjes së kredive (kredisë brenda ditës, kredisë njëditore ose kredisë lombard) të vendosin si garanci edhe obligacionet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Vendosja e obligacioneve si garanci, sjell ndryshim në llogaritjet e paraqitura në tabelën F, për sa i përket formulës së aplikuar për llogaritjen e vlerës së tregut të letrës me vlerë si dhe marzhit reduktues të aplikuar, i cili sikundër është paraqitur në tabelën 6, në rast se letra me vlerë ka maturim të mbetur më të gjatë se 1 vit, është 6 për qind përkundrejt 3 për qind, kur maturimi i mbetur i letrës është më pak se një vit.

Formula e përdorur për gjetjen e vlerës së tregut të obligacioneve paraqitet në tabelën G. Kjo formulë ka parimin e mbajtjes së pandryshuar të kuponit gjatë periudhës së obligacionit. Ndërkohë që në tregun shqiptar ekzistojnë edhe obligacionet 5-vjeçare, të cilat janë me kupon të ndryshueshëm. Në mungesë të kuotimit të çmimeve për këto lloj obligacionesh, formula që përdoret për vlerësimin e tyre është e njëjtë me atë të obligacioneve me kupon të pandryshueshëm.

Tabelë G. Formula e llogaritjes të vlerës së tregut të obligacioneve.

$$\text{Vlera e tregut} = \text{çmimi} * \frac{\text{Vlerën nominale}}{100} + \text{Acc}$$

Në mënyrë analitike formula e çmimit dhe interesit akrud janë si më poshtë:

$$\text{Çmimi} = \left[\frac{100}{\left(1 + \frac{\text{yieldi}}{\text{frekuenca}}\right)^{\left(N=1+\frac{\text{DSC}}{E}\right)}} \right] + \left(\sum_{k=1}^N \frac{100 \times \frac{\text{kuponi}}{\text{frekuenca}}}{\left(1 + \frac{\text{yieldi}}{\text{frekuenca}}\right)^{\left(k-1+\frac{\text{DSC}}{E}\right)}} \right) - \left(100 \times \frac{\text{kuponi}}{\text{frekuenca}} \times \frac{A}{E} \right)$$

Ku:

DSC - numri i ditëve nga data e tregtimit deri tek data e kuponit më të afërt;

E - numri i ditëve në periudhën e kuponit në të cilën ndodh tregtimi;

A - numri i ditëve nga fillimi i periudhës së kuponit deri në datën e tregtimit;

N - numri i kuponëve.

$$A_c = 100 \times \frac{\text{kuponi}}{\text{frekuenca}} \times \sum_{i=1}^{NC} \frac{A_i}{NL_i}$$

Ku:

A_c - interesi i përlogaritur;

A_i - numri i ditëve nga kuponi i fundit deri në datën e tregtimit;

NL - numri i ditëve brenda një periudhe kuponi.

Duke marrë përsëri shembullin e kredisë lombard me vlerë 100 milionë, të paraqitur në tabelën F, zëvendësojmë bonon e thesarit me obligacionin 5-vjeçar. Ky zëvendësim do të sjellë ndryshim vetëm në shifrat e *interesit të tregut*, *vlerës së tregut* dhe *vlerës së tregut pas marzhit reduktues* ndërkohë që të dhënat e tjera mbeten të njëjta me rastin e vlerësimit të bonove të thesarit. Të dhënat dhe vlerësimi i obligacionit 5-vjeçar janë në tabelën H. Si shembull, është marrë e njëjta vlerë nominale me bonon e thesarit në tabelën F, pra 118 milionë. Vlera e tregut e obligacionit 5-vjeçar rezulton 119.10 milionë, vlerë kjo që e axhustuar me marzhin reduktues, rezulton 115.53 milionë lekë. Kjo vlerë është më e lartë se vlera e kredisë e axhustuar me marzhin fillestar (110 milionë lekë). Në këtë rast, banka mund të vendosë të ulë vlerën nominale të garancisë deri në 113 milionë lekë, vlerë kjo që korrespondon me një vlerë tregu të axhustuar me marzhin reduktues prej 110.64 milionë lekësh, pothuajse e barabartë me vlerën e kredisë të axhustuar me marzhin fillestar.

Tabelë H: Llogaritja e vlerës së tregut të obligacionit 5-vjeçar.

Data e emetimit	08/08/08
Data e vlerësimit	08/09/08
Data e maturimit	08/08/13
Data e kuponit më të afërt	08/02/09
Interesi i tregut në datën e vlerësimit	9.00000%
Kuponi	9.05000%
Frekuenca e kuponit	1 herë në 6muaj
Baza	30/360*
Vlera nominale	118.00
Çmimi	100.181
Interesi i përlogaritur	0.89
Vlera e tregut	119.10

* Baza përcaktohet nga Ministria e Financave.

Të gjithë hapat e tjerë që ndiqen për të ruajtur vlerën e garancisë me bono thesari aplikohen edhe në rastin e garancisë me obligacion. Për të gjetur vlerën nominale të garancisë, që duhet të kërkohet shtesë nga banka (ose t'i rikthehet bankës), në rast se kjo garanci shtesë do të jetë përsëri obligacion aplikohet formula e gjetjes së vlerës së tregut (Tabela G) e zgjidhur për vlerën nominale.

ANEKSI 2. FJALOR.

Ankand - është procedura për realizimin e ndërhyrjeve në tregun e parasë që organizohet nga rregulla, të cilët përcaktojnë shpërndarjen e fondeve në bazë të kërkesave të bëra nga bankat.

Ankand standard - është ankandi që zhvillohet brenda 24 orëve nga njoftimi i Departamentit të Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë. Data e zhvillimit të këtij ankandi është e përcaktuar paraprakisht.

Ankand i shpejtë - është ankandi që zhvillohet të paktën një orë nga njoftimi i Departamentit të Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë. Data e zhvillimit të këtij ankandi nuk është e përcaktuar paraprakisht.

Ankand me çmim fiks - është ankandi i marrëveshjes së riblerjes / të anasjelltë të riblerjes, i organizuar nga Banka e Shqipërisë, në të cilin plotësimi i kërkesave të pjesëmarrësve bëhet sipas interesit të riblerjes, të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

Ankand me shumë çmime - është ankandi i marrëveshjes së riblerjes/të anasjelltë të riblerjes, i organizuar nga Banka e Shqipërisë, në të cilin plotësimi i kërkesave të pjesëmarrësve bëhet sipas interesit të riblerjes, të kërkuar nga bankat.

Banka - janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Blerës - është subjekti në marrëveshjen e riblerjes, që merr përsipër të blejë letra me vlerë nga shitësi dhe t'i rishesë ato në fund të periudhës së marrëveshjes. Ky subjekt mban këtë emër, të përcaktuar gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes.

Baza e rezervës - është bashkësia e detyrimeve të një banke, e vrojtuar në ditën e fundit të periudhës bazë, për të cilën do të mbahet rezervë e detyruar.

Gjobë - është shuma monetare në formë kamatëvonese, që banka dhe dega e bankës së huaj detyrohet të paguajë, për mosplotësimin e rezervës së detyruar sipas dispozitave të rregullores në fuqi.

Instrument rregullues i Bankës së Shqipërisë - është instrumenti i tregut të hapur, që përdoret nga Banka e Shqipërisë për realizimin e ndërhyrjeve në tregun e parasë. Ky instrument ka për qëllim rregullimin e likuiditetit dhe të strukturës së tij.

Instrument kryesor i zbatimit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë - është instrumenti i rregullt i tregut të hapur, që përdoret nga Banka e Shqipërisë në bazë javore, për të realizuar ndërhyrjet në tregun e parasë me qëllim administrimin e likuiditetit të sistemit bankar. Instrumenti kryesor i zbatimit të politikës monetare është marrëveshja e riblerjes/e anasjelltë e riblerjes me maturim njëjavor.

Interes i përllogaritur - është interesi i akumuluar mbi vlerën e një obligacioni që prej datës së pagesës së fundit të interesit, deri në ditën (por pa e përfshirë atë) e vlerësimit të obligacionit.

Interes i riblerjes - është norma e interesit e përcaktuar nga palët në një marrëveshje riblerjeje ose të anasjelltë riblerjeje, me të cilën do të riblihen letrat me vlerë. Ky interes shprehet në përqindje në bazë vjetore, dy shifra pas presjes dhjetore.

Interes i tregut - është interesi i paguar për instrumentet e përdorura në tregun ndërbankar dhe sekondar të letrave me vlerë, i përcaktuar nga kërkesa dhe oferta në këtë treg. Në mungesë të përcaktimit të interesit në tregun ndërbankar dhe sekondar të letrave me vlerë, interesi i tregut do të llogaritet në bazë të kurbës lineare të interesit, të përfutur nga interesi bazë dhe *yield*-et e bonove të thesarit.

Kërkesë - është shprehja e vullnetit të bankës, për të marrë pjesë në ankandet e marrëveshjeve të riblerjes/të anasjellta riblerjes, duke përcaktuar shumën dhe interesin e riblerjes.

Kohëzgjatja e realizimit të ndërhyrjes - është periodha e përcaktuar për realizimin e ndërhyrjes në tregun e parasë.

Kontratë - Tip për marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes - është kontrata njëvjeçare, e lidhur midis Bankës së Shqipërisë dhe një banke, e cila nënshkruhet përpara lidhjes së marrëveshjes së riblerjes/të anasjelltë të riblerjes, me qëllim zbatimin e kësaj të fundit.

Kredi brenda ditës - është instrument i Bankës së Shqipërisë me maturim

brenda ditës së punës, që ka për qëllim plotësimin e nevojave për likuiditet të bankave brenda ditës dhe garantimin e vijueshmërisë së punës së sistemit të pagesave të Bankës së Shqipërisë.

Komiteti i Zbatimit të Politikës Monetare - është organ vendimmarrës i Bankës së Shqipërisë, të cilit Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë i ka akorduar të drejta për të marrë vendim, në lidhje me ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun e këmbimeve valutore.

Lehtësi e përhershme - është instrument i bankës qendrore që në kushte normale është gjithnjë i disponueshëm për bankat, për të lehtësuar menaxhimin e likuiditetit të tyre.

Lëvizje e pranueshme e nivelit të interesit - është kufiri maksimal ose minimal i pranueshëm i devijimit të nivelit të interesit të kërkuar nga bankat, në krahasim me nivelin e interesit të tregut.

Ligji për bankat - është ligji "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", nr. 9662, datë 18.12.2006.

Ligji për Bankën e Shqipërisë - është ligji "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar nr. 8269, datë 23.12.1997.

Llogari rezervë - është llogaria e bankës pranë Bankës së Shqipërisë.

Marrëveshje riblerjeje - është marrëveshja me anë të së cilës Banka e Shqipërisë shet letra me vlerë, duke marrë përsipër t'i blejë ato sipas kushteve të rëna dakord paraprakisht me një bankë, me qëllim zvogëlimin e përkohshëm të likuiditetit në sistemin bankar.

Marrëveshje e anasjelltë riblerjeje - është marrëveshja me anën e së cilës, Banka e Shqipërisë blen letra me vlerë duke marrë përsipër t'i shesë ato sipas kushteve të rëna dakord paraprakisht me një bankë, me qëllim rritjen e përkohshme të likuiditetit në sistemin bankar.

Normë e rezervës së detyruar - është përqindja e bazës së rezervës së detyruar.

Ndërhyrje në tregun e parasë - është realizimi nga Banka e Shqipërisë i operacioneve të tregut të hapur me bankat, me synim administrimin e likuiditetit të sistemit bankar.

Normë bazë e interesit - është interesi i riblerjes i marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, i përcaktuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Normë e pjesëmarrjes - është raporti i shumës së kërkesave të një banke ndaj shumës së shpallur nga Banka e Shqipërisë në ankandin me shumë çmime, e shprehur në përqindje.

Normë e ponderuar e interesit - është norma mesatare e interesit, e llogaritur si shumë e kontributit të çdo komponenti (interesi). Kontributi llogaritet si pesha specifike e vlerës monetare që i korrespondon çdo norme të ndryshme interesi ndaj vlerës monetare totale.

Periudhë bazë - është çdo muaj kalendarik fundi i të cilit shërben për monitorimin e bazës së rezervës së detyruar, me qëllim llogaritjen e rezervës së detyruar.

Periudhë e mbajtjes - është periudha në të cilën bankat mbajnë rezervën e detyruar në Bankën e Shqipërisë.

Procedurë dypalëshe - është mënyra për realizimin e ndërhyrjeve në tregun e parasë, në të cilën bankat kontaktohen individualisht nga Banka e Shqipërisë.

Proratë - është raporti i sasisë së mbetur deri në plotësimin e shumës së shpallur, me shumën e kërkesave me interes të barabartë riblerjeje.

Shitës - është subjekti në marrëveshjen e riblerjes, që merr përsipër t'i shesë letra me vlerë blerësit dhe t'i riblejë ato në fund të periudhës së marrëveshjes. Ky subjekt mban këtë emër, të përcaktuar, gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes.

Remunerim - është shuma e interesit që paguhet nga Banka e Shqipërisë për bankat, për rezervën e detyruar të mbajtur nga këto të fundit në Bankën e Shqipërisë.

Rezervë e detyruar - është niveli minimal i rezervës që një bankë është e detyruar të mbajë pranë Bankës së Shqipërisë. Rezerva e detyruar llogaritet si prodhim i bazës së rezervës me normën e rezervës së detyruar.

Rezultat agregat - është një përmbledhje e rezultatit të përgjithshëm të ankandit ose të procedurave dypalëshe.



